



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 401/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, kryesues Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ukë Berisha, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA -PSHDK, dega në Klinë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara ankesat Anr.401/2017, Anr.402/2017, Anr.403/2017, Anr.404/2017, Anr.405/2017, Anr.406/2017 te datws 30.06.2017, te Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ukë Berisha, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimet 2621D/02R, 2101B/03R, 2105B/03R, 2124B/02D, 2102B/01R - 2102B/02D, 2103B/01R, 0201C/01R, 2105B/03R, 0204C/04R, 0215C/3D, 0226C/3R, 0806C/02R, 0816C/02D, 3032A/04D, 3035A/01R/02D, 0308E/01R, 0309E/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive te votimeve ne Vendvotimet si në pikën -II-, të këtij dispozitivi vendimi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat me datën 30.06.2017 në ora 13:00, nga Ukë Berisha kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA -PSHDK në të cilën ankesa ka theksuar se:

Ankesa Anr. 401/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se në Viti në vendvotimin 2621d/02R sipas QNR ka 2 vota kurse në FRK 3 vota.

Ankesa Anr. 402/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se në Skenderaj në vendvotimin 2101B/03R sipas QNR ka 0 vota kurse në FRK 1 votë, në vendvotimin 2105B/03R sipas QNR 0 vota kurse FRK - 1 votë, në

vendvotimin 2124B/02D sipas QNR-së 4 vota kurse FRK 5 vota, në Qubrel 2102B/01R dhe 2102B/02D janë vetëm 47 vota, por në bazë të familjeve (Teraku, Mulaj, Spahiu, Fazliaj, Topalli dhe Miftari) duhet të ketë shumë më shumë vota, në vendvotimin 2103B/01R në fshatin Likovc është 1 votë por familja Sylkaj deklaroi se ka më shumë vota, në vendvotimin 2112B në fshatin Kllodernicë familja Abazi deklaroi se kanë votuar 76 familjar me të drejt vote, në fshatin Runik 2114B familja Sejdiu ka deklaruar se janë 48 vota kurse në FRK 0vota, në 2105B familja Smajli nga fshati Prekaz deklaroi se janë 78 vota kurse në FRK 0 vota.

Ankesa Anr. 403/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se në Gjakovë në vendvotimin 0201C/01R figuron në QNR 0 vota kurse në FRK 11 vota, në vendvotimin 0204C/04R në QNR janë 4 vota kurse në FRK 5 vota, në vendvotimin 0215c/03D QNR-së 24 vota kurse në FRK 27 vota, në vendvotimin 0226c/3R QNR 77 kurse në FRK 95 vota.

Ankesa Anr. 404/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se në Klinë në vendvotimin 0806c/02R në bazë të vëzhguesit dhe FRK kanë qenë 37 vota në QNR figuron 0 vota dhe në vendvotimin 0816c/02D duhet të jenë 67 vota e jo 7 vota që figuron në QNR.

Ankesa Anr. 405/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se sipas të dhënave në Malishevë të marra nga Lavdim Zulfaj vëzhgues i PAN-it i cili ishte në vendvotim nr. 3030a në Malishevë ka dëshmuar se kandidati i koalicionit PAN me nr 41 ne dy vendvotimet e fshatit Senik ka pasur 141 vota, ndërsa ne FRK evidentohet shifra 0 vota, në vendvotimin nr 3032A/04D Malishevë ishin 7 vota kurse në FRK figuron vetëm 2 vota dhe poashtu në fshatin Llazicë 3035A/01R -02D kumungojn votat e familjes Foniqi 29 vota.

Ankesa Anr. 406/2017, është e parashtruar nga Ukë Berisha, me të cilën pretendohet se në Drenas në vendvotimin 0308E/01R sipas QNR - 1 votë kurse sipas FRK -2 vota, në vendvotimin 0309E/01R sipas QNR – 0 vota sipas QNR – 0 vota, kurse FRK 4 vota, në bazë të deklaratës së familjes Kurti në Abri në vendvotimin 0307E që janë 113 vota, në fshatin Tërstenik 0306E sipas familjes Demaku deklaroi se janë 84 vota kurse në FRK 0 vota.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat Anr. 401/2017, Anr. 402/2017, Anr. 403/2017, Anr. 404/2017, Anr. 405/2017, Anr. 406/2017, të datës 30.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 401/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Parashtruesi i ankesës si prova materiale bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojn edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.401/2017 më datën 01.07.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*